



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E SHITES**  
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITE**



**Drejtoria për Arsim**  
**Uprava za Obrazovanje/Department of Education**

Nr. i Protokollit: 05/ 195

Data: 6. 6. 2018

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/ L- 52, Ligji Nr. 03/ L-068 dhe Ligji Nr. 04/ L-32) dhe me qëllim të mënjanim të diskriminimit me rastin e pranimit të fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shite, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit merr:

**V E N D I M**

**PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN  
PARASHKOLLOR “ALBIONA ASLLANI” NË SHITE**

Të gjithë fëmijët e prindërve banorë të komunës së Shites dhe ata të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë vendim, nga mosha 09 muaj – 4 vjeç mund të regjistrohen në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani”. Fëmijët e komunave tjera mund të regjistrohen vetëm atëherë kur nuk plotësohet numri i fëmijëve në institucionin e sipërprërmendur.

Planifikimin e numrit të fëmijëve që do të pranohen në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” e bën vetë institucioni në fjalë, në përputhje me infrastrukturën ligjore dhe kapacitetet fizike dhe profesionale.

Moshën e fëmijëve dhe grup-moshat i përcakton vetë Institucioni Parashkollor “Albiona Asllani”, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kapacitetet fizike e profesionale. Llogaritja e moshës bëhet në bazë të datës së fillimit të marrjes së shërbimit dhe jo me rastin e regjistrimit.

Pranimi i fëmijëve do të bëhet në bazë të numrit të pikëve të grumbulluara sipas kriterëve të poshtëshënuara në tabelë:

| Nr. | Kategoria/Kriteri                                                        | Pikët |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|-------|
| 1   | Fëmijët, të cilët kanë vijuar vitin e paraprak në IP “Albiona Asllani”   | 100   |
| 2   | Fëmijët, me të dy prindërit e punësuar                                   | 95    |
| 3   | Fëmijët, me njërin prind të punësuar (me përparësi nëna e punësuar)      | 90    |
| 4   | Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit                                       | 85    |
| 5   | Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar | 80    |
| 6   | Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar   | 75    |
| 7   | Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon    | 70    |

|    |                                                                               |    |
|----|-------------------------------------------------------------------------------|----|
| 8  | Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon               | 65 |
| 9  | Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë         | 60 |
| 10 | Fëmijët me nevoja të veçanta ( <b>të lehta</b> ) nëse asnjëri prind nuk punon | 55 |
| 11 | Fëmijët me nevoja të veçanta ( <b>të lehta</b> ) nëse njëri prind punon       | 50 |
| 12 | Fëmijët me nevoja të veçanta ( <b>të lehta</b> ) nëse të dy prindërit punojnë | 45 |
| 13 | Fëmijët me të dy prindërit me nevoja të veçanta                               | 40 |
| 14 | Fëmijët me njërin prind me nevoja të veçanta                                  | 35 |
| 15 | Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar     | 30 |
| 16 | Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar       | 25 |
| 17 | Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon         | 20 |
| 18 | Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon               | 15 |
| 19 | Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë         | 10 |
| 20 | Fëmijët, me të dy prindërit të papunësuar                                     | 5  |

**Vërejtje:** Të gjitha kategoritë e përfshira në tabelën e sipërme, duhet të dëshmojnë me dokumente valide nga institucionet përkatëse statusin e tyre.

Drejtori,  
Mensur NEZIRI